

ZRRUM – R 05 / SWC

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA (“ZRRUM”)

RREGULL

PËR FALJEN DHE RREGULLIMIN E BORXHEVE TË VJETRA

PËR

**OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË GRUMBULLIMIT TE MBETURINAVE
NË KOSOVË**

26 – Janar – 2005

TABELA E PËRMBAJTJES	
TABELA E PËRMBAJTJES	2
PJESA 1 DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME	4
Kapitulli 1 : Autoriteti, Fushëveprimi, Qëllimi dhe Definicionet	4
Neni 1 : Autoriteti për këtë Rregull.....	4
Neni 2 : Fushëveprimi	4
Neni 3 : Qëllimi.....	4
Neni 4 : Përkufizimet	4
Neni 5 : Rregullat e Interpretimit	7
Kapitulli 2 : Parimet e Përgjithëshme.....	8
Neni 6 : Zbatueshmëria	8
Neni 7 : Parimet Bazë	8
Neni 8 : Mos-Diskriminimi	8
PJESA 2 PROCEDURAT	9
Kapitulli 1 : Borxhet e Vjetra	9
Neni 9 : Rregullimi dhe Falja e Borxheve të Vjetra.....	9
Neni 10 : Kushtet për Faljen dhe Rregullimin e Borxheve të Vjetra.....	9
Neni 11 : Shlyerja e Borxheve të Vjetra	9
Kapitulli 2 : Marrëveshjet për Pagesë dhe Kontestet	10
Neni 12 : Marrëveshjet për Pagesë.....	10
Neni 13 : Kontesti i Besueshëm i Faturës	10
Neni 14 : Mos pagesa e vazhdueshme e Faturave	11
Kapitulli 3 : Situatat Speciale.....	11
Neni 15 : Të Varfërit dhe Skamnorët.....	11
Neni 16 : Prona e Braktisur ose e Boshatisur.....	11
Neni 17 : Pronari apo Banori i Ri.....	12
Kapitulli 4 : Shënimet dhe Raportet	12
Neni 18 : Shënimet.....	12
Neni 19 : Raportet	12
PJESA 3 TË NDRYSHME	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
Neni 20 : Gjuhët.....	Error! Bookmark not defined.
Neni 21 : Hyrja në Fuqi.....	Error! Bookmark not defined.
Neni 22 : Kohëzgjatja.....	Error! Bookmark not defined.
SHTOJCAT SHTOJCA 1	14
SHTOJCA 1.....	15
SHEMBULL I FORMULARIT PËR PËRMbledhjen e BORXHEVE TË VJETRA.....	15
SHTOJCA 2.....	17

MODELI I KONTRATËS PËR MARRËVESHJEN E PAGESËS 17

PJESA 1 DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Kapitulli 1 : Autoriteti, Fushëveprimi, Qëllimi dhe Definicionet

Neni 1 : Autoriteti për këtë Rregull

Rregullatori nxjerr këtë Rregull nën autoritetin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave i datës 26. Nëntor 2004”.

Neni 2 : Fushëveprimi

Të gjithë Ofruesit aktual të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të veprojnë konform kërkesave të kësaj Rregulle në lidhje me rastet e Rregullimit dhe faljes së Borxheve të Vjetra që atyre ju kanë ndonjëri ose të gjithë Konsumatorët e tyre.

Neni 3 : Qëllimi

- 3.1 Qëllimi i kësaj Rregulle është mundësimi i afateve dhe i kushteve për Konsumatorët që të përfitojnë nga falja e Borxheve të Vjetra dhe për rregullim për pjesën që nuk do të falet dhe të u mundësojnë Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave shlyerjen nga shënimet e tyre të afarizmit Borxhet e Vjetra kthimi i pjesërishëm ose i tërsishëm i të cilave nuk duket të jetë i mundshëm.
- 3.2 E drejta për falje dhe/ose shlyerje të Borxheve të Vjetra sipas kësaj Rregulle është e kushtëzuar me njohjen nga ana e Konsumatorit të përgjegjesisë së tij për të paguar të gjitha Faturat e tanishme sikur edhe të atyre që duhet të vijnë pas periudhës së amnestisë të mbuluar nga Kontrata për Pagesë të Borxheve të Vjetra.

Neni 4 : Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregull do të përmbajnë kuptimet si në vijim:

“**Autoriteti Menaxhues**” nënkupton autoritetin dhe pushtetin e dhënë nën marrëveshjen me shkrim që lidhet në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe cilitdo Ofrues tjetër të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me të cilën në mënyrë të veçantë deklarohet se (1) Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i dedikuar për atë qëllim në Konsolidim është i autorizuar dhe përgjegjës për mbikqyrjen menaxhuese dhe operuese të cilitdo Ofrues tjetër të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave e operon në Zonën e Shërbimit dhe (2) Ofruesi tjetër i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimit do të jetë në pajtim me kërkesat e marrëveshjes në fjalë;

“**Banor**” nënkupton personin e gjallë që jeton brenda Zonës së Shërbimit;

“**Borxhet e Vjetra**” nënkupton të gjitha borxhet e Konsumatorëve lidhur me Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave që janë të evidentuara me Fatura të pakontestueshme të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave tek ai Konsumator me apo para 31 dhjetor 2002 dhe të cilat nuk janë paguar në tërësi siç është definuar dhe rregulluar në Rregullën e caktuar mbi Borxhet e Vjetra që lëshohet, ndryshohet dhe/ose plotësohet nga Rregullatori kohë pas kohe;

- “Ditë Pune”** nënkupton cilado ditë përveç të shtunës dhe të dielës, festë e paraparë më ligj apo ditë tjetër që është Festë Zyrtare në Kosovë;
- “Falja e Borxheve të Vjetra”** nënkupton Ofruesin e Shërbimeve për Mbledhjen e Mbeturinave si kreditor do të ndërprejë çdo veprim në vazhdim e sipër ose në të ardhmen ndaj secilit Konsumatorë borxhli që të mbledhë cilat do Fatura të papaguara ose pjesët e saj dhe do të zbres shumën e falur nga shënimet e veta afariste;
- “Fatura”** nënkupton dokumentin me shkrim që dërgohet tek Konsumatori me qëllim të caktuar për të ngarkuar Konsumatorët për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave të ofruara ose ndonjë entitet tjetër ligjor që ka të drejtë të bëjë një gjë të tillë dhe me një format dhe përmbajtje që ipet në këtë Rregull;
- “Festë Zyrtare”** nënkupton cilendo ditë që njifet ose e dedikuar nga autoritetet qeveritare si ditë që nuk punohet;
- “Karta e Konsumatorëve”** nënkupton dokumentin e shkruar që është pregaditur nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe që i është vënë në dije secilit Konsumator dhe i cili rradhinë të drejtat dhe obligimet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të Konsumatorëve që kanë ndaj njëri tjetrit.
- “Komision Shqyrtues”** nënkupton komisionin e themeluar nga Rregullatori konform Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;
- “Komisioni Këshillues i Konsumatorëve”** nënkupton komisionin e themeluar nga Rregullatori konform Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;
- “Komuna”** nënkupton Komunitet lokal të paraqitura në Planin A në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/43 të 27 korrikut 2000 Mbi Numrin, Emrat dhe Kufijtë e Komunave në datën kur kjo Urdhëresë Administrative ka hy në fuqi
- “Konsumator Shtëpiak”** nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;
- “Konsumator Institucional”** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Mbi Regjistrimin e Organizatave Afariste në Kosovë.
- “Konsumator Komercial-Industrial”** nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumator i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
- “Konsumator”** nënkupton një person, që ka hyrë në Kontratë Shërbimi me një Ofrues të Shërbimeve ose ka marrë shërbime të ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve;
- “Konsumatori i varfër”** nënkupton Konsumatorin e regjistruar në Skemën e Ndihmës Sociale të Kosovës ose në skema të ngjajshme të përgatitura nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

- “Kontestimi i Besueshëm i Faturës”** nënkupton kontestin lidhur me Faturën e lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Mbledhjen e Mbeturinave që iniciohet nga Konsumatori me shkrim para se ajo Faturë të bëhet e pagueshme;
- “Kontejneri për Mbeturina”** nënkupton cilindo lloj të kontejnerëve ose shportat për mbajtjen e Mbeturinave të Ngurta Komunale të grumbulluara para mbledhjes dhe/ose heqjes së tyre;
- “Kontratë për Pagesën e Borxheve të Vjetra”** nënkupton marrëveshjen me shkrim të lidhur në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Mbledhjen e Mbeturinave dhe Konsumatorin me qëllim të bërjes së Rregullimit të Pagesës;
- “Kontratë e Shërbimit”** nënkupton marrëveshjen me shkrim në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe Konsumatorëve të tij që i referohet Nenit 15 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;
- “Letër Jo-Kundërshtuese”** nënkupton letrën e lëshuar nga Rregullatori që deklaron jo kundërshtim për cilatdo veprime të cilave iu përgjigjet, megjithatë nuk bart vërtetim ose aprovim;
- “Licenca e Shërbimit”** nënkupton Licencën e lëshuar nga Rregullatori konform Rregullës së lëshuar nga Rregullatori, që autorizon Ndërmarrjet në Pronësi Publike ose Private të ofrojnë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave për publikun;
- “Marrëveshja për Pagesë”** nënkupton marrëveshjen në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të Konsumatorëve me qëllim të pagesës së Borxheve të Vjetra dhe siç është e definuar dhe e rregulluar në Rregullën e caktuar mbi Borxhet e Vjetra që lëshohet, ndryshohet dhe/ose plotësohet nga Rregullatori kohë pas kohe;
- “Mbeturina të Ngurta Komunale”** nënkupton Mbeturinat e ngurta jo të rrezikshme të prodhuara nga amvisëritë, burimet komerciale dhe afariste, institucionale dhe Mbeturinat e procesuara industriale që nuk janë të rrezikshme;
- “Objekti i Licensuar për Deponim”** nënkupton objektin i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe ku entiteti operues i objektit është i licensuar nga Rregullatori për të operuar në atë objekt;
- “Ofrues i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave”** nënkupton secilin Person që ofron apo ka për qëllim të ofrojë Shërbim të Grumbullimit të Mbeturinave;
- “Parapagimi i Detyrueshëm”** nënkupton shumën e të hollave që Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i kërkon nga Konsumatori për arsye të posaçme që aplikohen ndaj pagesave për Faturat e ardhshme të ngarkuara në Konsumatorin në lidhje me Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave;
- “Person i Cenueshëm”** nënkupton cilindo Konsumator të klasifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si i varfër dhe skamnor;
- “Plani i Konsolidimit”** nënkupton planin e ristrukturimit të sektorit që është krijuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) për konsolidim dhe ristrukturim të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, dhe të Ofruesve të Shërbimeve të Mbeturinave për Mbledhjen e Mbeturinave të

datës 10 shtator 2002 e ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar kohë pas kohe nga ana e Rregullatorit;

- “**Programi Kosovar i Asistencës Sociale**” nënkupton cilin do program nën apo që administrohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që cakton kriteret për te dhe verifikon të drejtën e njerëzve të varfër dhe të lënë ekonomikisht anash për t’u zgjedhur (pranuar);
- “**Regjistri i Konsumatorëve**” nënkupton regjistrin e krijuar, të ruajtur dhe të mbajtur nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe i cili përmban informacione përkatëse për Konsumatorin siç ipet në hollësi në këtë Rregull;
- “**Rregullator**” nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Kosovë nën ligjin e aplikueshëm;
- “**Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave Shtëpi-më-Shtëpi**” nënkupton shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave të Ngurta Komunale nga njësitë individuale me nga një familje ose Banesave;
- “**Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave**” nënkupton Grumbullimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale dhe bartjen e tyre deri te Objekti i Licensuar për Deponim;
- “**Shlyerja e Borxheve të Vjetra**” nënkupton procesin me të cilin Ofruesi i Shërbimeve për Mbledhjen e Mbeturinave pajtohet të shkarkojë Konsumatorin nga pagesa në tërësi e cila do Borxheve të Vjetra ose një pjesë sipas afateve dhe kushteve të Rregullimit të Pagesës.
- “**Standardet e Shërbimit**” nënkupton sa i përket Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave, standardet që aplikohen ndaj atij Shërbimi në përputhje me Rregullën e Standardeve të Shërbimit dhe nivelin minimal të standardeve që aplikohen ndaj atij shërbimi të përcaktuara nga Rregullatori në Kushtet e Licencës së Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave;
- “**Tarifat e Shërbimit**” nënkupton çdo vlerë, çmim apo taksë të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në lidhje me dispozitat e shërbimeve të tij ndaj Konsumatorëve të vet;
- “**Vendbanim**” nënkupton çdo shtëpi, banesë, vendbanim shumë-bloqesh, ndërtesë banimi, apo ndonjë hapsirë tjetër e përdorur për qëllime banimi;
- “**Vendbanim**” nënkupton cilëndo vendndodhje për të cilin janë të kërkuar ose janë ofruar Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave;
- “**Zona e Shërbimit**” nënkupton, në lidhje me Licensimin e Shërbimit, rajonin apo Komunën brenda së cilës Ofruesi përkatës i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mund të ofrojë shërbimet e veta;

Neni 5 : Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Çdo term apo shprehje e përdorur në këtë Rregull, që nuk është definuar në mënyrë specifike dhe që mund të jetë diskutabile, do të ketë kuptimin ashtu siç definohet në aktet ligjore të referuara në Rregulloren e UNMIK-ut që

autorizon këtë Rregull apo në ndonjë tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe

- (b) Referimet në Rregull do të kenë kuptimin e cilëso Rregull të lëshuar, ndryshuar, shtuar, plotësuar, dhe/apo zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe konform kompetencave që i janë dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi e përfshinë shumësin dhe e kundërta; dhe
- (d) Fjalët e çfarëdo gjinie të përdorura në këtë Rregullore do të përfshijnë cilën do gjini tjetër; dhe
- (e) Referencat për Pjesët, Kapitujt, dhe Paragrafet, përveç nëse shprehimisht nuk caktohet ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Paragrafe të këtij Rregulli.

Kapitulli 2 : Parimet e Përgjithëshme

Neni 6 : Zbatueshmëria

Të gjithë Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ju kërkohet që të respektojnë këtë Rregull nëse dëshirojnë të falin ose të bëjnë rregullimin e Borxheve të Vjetra.

Neni 7 : Parimet Bazë

7.1 Asgjë e thënë në këtë Rregull nuk duhet kuptohet:

- (a) Lirim i Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nga obligimi i ofrimit të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave për Konsumatorët; dhe
- (b) Lirim i Konsumatorëve nga obligimet për të paguar Faturat e dorëzuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave për kryerjen e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave; dhe
- (c) Pamundësimin e Konsumatorit që të kontestojë shumën e Faturës, duke i ofruar Konsumatorit mundësi për ankesë në përputhje me procedurat e vendosura nga Rregullatori për rregullimin e kontesteve në lidhje me shumën e faturave.

7.2 Në vijim të nën-Nenit të më lartë 7.1, Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave mundet, konform autorizimit nga Rregullatori, të fal dhe shlyej Borxhet e Vjetra të çdo Konsumatori apo të mirret vesh me cilin do Konsumator që të rregullojë Borxhet e Vjetra përmes Marrëveshjes për Pagesë sa herë që udhëhiqet nga arsyet ekonomike dhe menaxheriale dhe që bëhet në mënyrë jodiskriminuese.

7.3 Për menjanim të dyshimit, Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave ka të drejtë por jo obligim që të hyjë në ndonjë marrëveshje ligjore, sipas ligjeve të Kosovës, me Konsumatorin për qëllim të rregullimit ose faljes së Borxheve të Vjetra përmes Marrëveshjes për Pagesë.

Neni 8 : Mos-Diskriminimi

Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave nuk duhet të bëjë diskriminim ndaj asnjë Konsumatori në baza racore, etnike, kulturore, ose ekonomike ose në lidhje me standardin e jetesës së Konsumatorit që jeton në çfarëdo pjese të Zonës së Shërbimit, në aplikimin e politikave të tij për faljen dhe rregullimin e Borxheve të këqija.

PJESA 2 PROCEDURAT

Kapitulli 1 : Borxhet e Vjetra

Neni 9 : Rregullimi dhe Falja e Borxheve të Vjetra

- 9.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mund të falë ndonjërit ose të gjithë Konsumatorëve, njëqind për qind (100%) të shumës së Borxheve të Vjetra të evidentuara me Faturë të lëshuar para 31 dhjetorit 2000 duke përfshirë edhe këtë datë;
- 9.2 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave mund t'ju fal Konsumatorëve Shtëpiak, Industrial dhe Komercial deri në pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së Borxheve të Vjetra të evidentuara me Faturë të lëshuar mes 1 janarit 2001 dhe 31 dhjetorit 2001 përfshirë këtë datë. Konsumatori duhet të obligohet që të paguaj tërësisht pesëdhjetë për qind (50%) të shumës së bilansit të faturës së përmendur.
- 9.3 Të gjitha Borxhet e Vjetra të evidentuara me Fatura të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Mbledhjes së Mbeturinave mes 1 janarit 2001 dhe 31 dhjetorit 2001, ndaj Konsumatorëve Institucional dhe atyre Ndërkombëtarë nuk duhet të kualifikuar për falje të borxheve ashtu siç është vendosur me këtë Rregull por duhet të jenë të maturuara dhe të pagueshme në tërësi nga Konsumatorët e duhur
- 9.4 Të gjitha Borxhet e Vjetra të evidentuara me fatura të lëshuara, nga Ofruesi i shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave mes 1 janarit dhe 31 dhjetorit 2002 për të gjitha kategoritë e Konsumatorëve nuk duhet kualifikuar për falje të borxheve ashtu siç është vendosur me këtë Rregull por duhet të jenë të maturuara dhe të pagueshme në tërësi nga Konsumatori.

Neni 10 : Kushtet për Faljen dhe Rregullimin e Borxheve të Vjetra

Ofruesi i Shërbimeve të Mbledhjes së Mbeturinave është i autorizuar që të bëjë faljen ose të rregullojë Borxhet e Vjetra nëpërmjet Marrëveshjes së Pagesës nën kushtet vijuese:

- (a) Konsumatori dhe Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të ekzekutojnë, nëse është aplikuar, Kontratën e Shërbimit për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave; dhe
- (b) Konsumatori obligohet që të paguajë në tërësi Borxhin e Vjetër ose ndonjë pjesë të tij e cila nuk i është falur dhe duhet të ketë të drejtën të bëjë pagesën përmes Marrëveshjes për Pagesë ashtu siç përcaktohet në Nenin 12.
- (c) Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të ketë të drejtën që të anulojë cilin do proces që është duke u realizuar për Rregullimin e Borxheve të Vjetra me një Konsumator të caktuar në rast të dështimit nga ana e Konsumatorit në fjalë të paguajë ndonjë pjesë të Borxheve të Vjetra të cilat nuk janë falur lidhur me afatet dhe kushtet e vendosura në Marrëveshjen e Pagesës, ose dështon të paguaj tri (3) ose më shumë Fatura të lëshuara pas datës kur është nënshkruar Kontrata për Pagesën e Borxheve të Vjetra.

Neni 11 : Shlyerja e Borxheve të Vjetra

Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të jetë i obliguar që të përdor Standardet Kosovare të Kontabilitetit ose standardet tjera të kontabilitetit të pranueshme ndërkombtarisht dhe të autorizuar për përdorim në Kosovë për të bërë përshtatjet e

nevojshme në librat e llogarive të arkëtueshme të tij dhe të regjistrimeve financiare për të reflektuar çdo shumë të Borxheve të Vjetra të falura ose të zgjidhura ne pajtueshmëri me ndonjë Marrëveshje për Pagesë konform me këtë Rregull.

Kapitulli 2 : Marrëveshjet për Pagesë dhe Kontestet

Neni 12 : Marrëveshjet për Pagesë

- 12.1 Ashtu siç mund të bihet dakord me Konsumatorin, Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të lejojë Konsumatorin që të paguaj Borxhet e Vjetra në këste të njejta mujore gjatë periudhës kohore që nuk tejkalon dymbëdhjet (12) muaj.
- 12.2 Konsumatori duhet të jetë i obliguar që të bëjë pagesën e parë për shumën e dakorduar brenda dy (2) Ditëve të Punës pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Pagesë ose Kontratës për Pagesë të Borxhit të Vjetër ashtu siç është e aplikueshme.
- 12.3 Konsumatori duhet, përveç kërkesave nga Marrëveshja për Pagesë, të jetë i obliguar të bëjë në tërësi pagesat e njikohëshme të të gjitha Faturave aktuale për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave në momentin e maturimit të tyre.
- 12.4 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të konfirmojë me shkrim të gjitha Marrëveshjet për Pagesë dhe të lëshojë një kopje për Konsumatorin jo më vonë se pesë (5) Ditë Pune pas datës në të cilën një marrëveshje e tillë është bërë në mënyrë që t'i ofrohet Konsumatorit mundësia e shqyrtimit dhe verifikimit të kushteve dhe afateve për të cilat është rënë dakord.
- 12.5 Konfirmimi me shkrim i bërë sipas Nën-Nenit të lartë shenuar 12.3 duhet të informojë Konsumatorin për të drejtën e tij të kontaktojë brenda afatit prej maksimum dhjetë (10) ditësh pas datës në të cilin është marrur konfirmimi me shkrim, Komisionin Këshillues të Konsumatorëve të vendosur në Zonën e Shërbimit ku është i vendosur lokacioni i shërbyer ose prona, në rastin kur Konsumatori nuk pajtohet me afatet e konfirmimit të Marrëveshjes për Pagesë.
- 12.6 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave mundet në opcionin e tij të evidencojë Marrëveshjen e Pagesës të lidhur me Konsumatorin me mjetet e ekzekutimit të Kontratës për Pagesë të Borxheve të Vjetra në format të ngjajshëm me atë të ofruar shtojcë të këtij Rregulli.

Neni 13 : Kontesti i Besueshëm i Faturës

- 13.1 Në rast të ndonjë Kontesti te Besueshëm te Faturës, në çfarë do shume të maturuar nën Marrëveshjen për Pagesë, Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të mos ketë të drejtën që të ndërprejë ose ndal ofrimin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave.
- 13.2 Hetimet në lidhje me Kontestin e Besueshëm te Faturës të dalura nga Marrëveshja e Pagesës duhet të përfshijnë:
 - (a) Një shqyrtim të shënimeve afariste të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për të identifikuar datat në të cilat Faturat i janë dërguar Konsumatorit; dhe
 - (b) Shikimin e dëftesave të pagesës që i ka bërë Konsumatori për Ofruesin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave; dhe

- (c) Shqyrtim i Raportit Përmbledhës së Borxheve të Vjetra ashtu siç ipet në shtesën e kësaj Rregulle.
- 13.4 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të raportojë për rezultatet e hulumtimit të mbajtura sipas nën-Nenit të lartëshënuar 13.2 ndaj Konsumatorit dhe si vazhdim duhet të mirëmbajë shënimet me shkrim të hulumtimit së paku për dy (2) vite pas datës kur i janë raportuar Konsumatorit rezultatet.
- 13.5 Konsumatori duhet të ketë të drejtën që ti referohet Komisionit Këshillues të Konsumatorëve në përputhje me procedurat e themeluara për këto komisione, për çdo Çështje të Diskutueshme që nuk mund të zgjidhet miqësisht.

Neni 14 : Mos pagesa e vazhdueshme e Faturave

- 14.1 Konsumatori i cili nuk përmbush kushtet e Marrëveshjes për Pagesë të cilën e ka lidhur me Ofruesin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të ketë shumën e plotë të borxhit në faturat e tij, duke përfshirë Borxhet e Vjetra, që maturohen dhe janë të pagueshme brenda njëzet (20) Ditëve të Punës nga data e mosplotësimit të kushteve të Marrëveshjes për Pagesë.
- 14.2 Në rastin e paraparë me nën-nenin 14.1 më lartë, Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të përgatis një faturë që tregon tërë shumën e borxhit, datën në të cilën pagesa duhet të bëhet, vendin ku një pagesë e tillë mund të bëhet dhe t'ia dorëzoj atë Konsumatorit.
- 14.3 Mos-pagesa e vazhdueshme e të gjitha shumave të përcaktuara me Marrëveshje për Pagesë të maturuara dhe të pagueshme sipas nën-nenit 14.1 më lartë, ashtu si është evidentuar me faturën që përmendet në nën-nenin 14.2 më lartë duhet ti jap të drejtë Ofruesit të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave që të kërkojë kompensim përmes juridiksionit të gjykatave të Kosovës ose përmes mjeteve tjera ligjore që janë në dispozicion.

Kapitulli 3 : Situatat Speciale

Neni 15 : Të Varfërit dhe Skamnorët

- 15.1 Një Konsumator i regjistruar në Skemën për Ndihmë Sociale të Kosovës ose që është i klasifikuar nga Ministriua e Punës dhe Mirëqenies Sociale si i varfër dhe skamnor që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle nuk duhet të kërkojë të paguaj çfarëdo borxhesh para vitit 2003.
- 15.2 Pavarësisht nga kufizimet e nën-nenit 15.1 më lart, Konsumatori i përmendur duhet të paguaj të gjitha Faturat e lëshuara nga 1 janari 2003 nga Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave për Shërbim të Grumbullimit të Mbeturinave.

Neni 16 : Prona e Braktisur ose e Boshatisur

Konsumatori që kërkon rifillimin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave në një pronë ose ndërtesë që është e braktisur ose e boshatisur ose e konsideruar si e tillë nga Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave në shënimet e veta të punës, nuk duhet të mbahet përgjegjës për çfarëdo Faturash ose Borxhesh të Vjetra të papaguara të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave bërë në pronën ose ndërtesën e përmendur, nëse

Konsumatori i përmendur dëshmon pronësinë e mëparshme dhe/ose mos-shfrytëzimin e mëparshëm prej cili do anëtari të familjes ose të afërmëve të tij.

Neni 17 : Pronari apo Banori i Ri

- 17.1 Konsumatori është përgjegjës për faturat e papaguara duke filluar nga data e pronësisë ose banimit të tij.
- 17.2 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet ta marrë si bazë banimin prej një viti të plotë përveç nëse pronari i ri ose banori i ri është në gjendje të dëshmojë datën në të cilën pronësia apo banimi ka nisur, në të cilin rast shuma e Faturuar duhet të jetë vetëm për kohën e dhënë të fillimit të pronësisë apo banimit.
- 17.3 Data në të cilën pronësia apo banimi ka filluar mund të dëshmohet përmes:
 - (a) Datës së parashtrimit të aplikacionit nga Konsumatori për pranimin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave tek Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave; dhe/ose
 - (b) Datës së parashtrimit të aplikacionit për të marrë shërbimin e rrymës ose të ngrohjes qëndrore.
- 17.4 Koha e banimit duhet të kalkulohet nga Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave në njësitë të muajve të plotë dhe komplet duke filluar me muajin e parë të pronësisë apo banimit.

Kapitulli 4 : Shënimet dhe Raportet

Neni 18 : Shënimet

- 18.1 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të plotësojë me shënime Regjistrin e Konsumatorëve për të treguar në çdo kohë:
 - (a) Shumën e Borxheve të Vjetra që i ka secili Konsumator; dhe
 - (b) Shumën e Borxheve të vjetra të falura sipas kësaj Rregulle; dhe
 - (c) Balansin e Borxheve të Vjetra që mbetet për tu paguar nga Konsumatori ose sipas një Marrëveshje për Pagesë ose sipas një Kontrate për Pagesë të Borxheve të Vjetra; dhe
 - (d) Shumën e Faturave tjera të ndërlidhura që i takojnë Konsumatorit dhe që lidhen me Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave.
- 18.2 Shënimet e përgatitura dhe të mbajtura sipas nën-nenit 18.1 më lartë, duhet të mbahen në një mënyrë konfidenciale ashtu si kërkohet me Rregullën për Kartën e Konsumatorit.

Neni 19 : Raportet

- 19.1 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të përgatis dhe dorëzojë tek Rregullatori raportin përmbledhës për Borxhet e Vjetra që jep listën e të gjithë Konsumatorëve Institucionalë dhe Ndërmarrjeve Shoqërore që kanë një shumë të papaguar dhe që duhet të tregojë emrin e Konsumatorit, shumën e papaguar, periudhën e borxhit, dhe statusin e ripagesës dhe duhet të dërgojë një kopje të përmbledhjes së përmendur të raportit në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

- 19.2 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të përgatis dhe dorëzojë tek Rregullatori një përmbledhje të raportit për Borxhet e Vjetra që jep listën e të gjithë Konsumatorëve Ndërkombëtare që kanë një shumë të papaguar dhe i cili duhet të tregojë emrin e Konsumatorit, shumën e papaguar dhe statusin e ripagesës dhe ashtu si është më e përshtatshme dhe e aplikueshme për qdo grup Konsumatorësh brenda kësaj kategorie të Konsumatorëve duhet të dërgoj një kopje ose tek zyra e PSSP-së, ose tek Shefi i Shtyllës së BE-së ose tek Komandanti i KFOR-it ose tek shefi i organizatës joqeveritare ose tek entitetet tjera ndërkombëtare me seli jasht Kosovës që kanë pranuar Shërbime të Grumbullimit të Mbeturinave gjatë kohës së funksionimit apo veprimt në Kosovë.
- 19.3 Përmbledhja e raportit për Borxhet e Vjetra e paraparë me këtë Nen duhet të strukturohet në një mënyrë që reflekton formatin dhe përmbajtjen e propozuar në një shtesë të këtij Rregulli.

PJESA 3 TË NDRYSHME

Neni 20 : Gjuhët


- 20.1 Kjo Rregull nxjerret dhe publikohet në tri versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë, domethënë:
- (a) Anglisht
 - (b) Shqip
 - (c) Serbisht
- 20.1 Në rast të çfarëdo diskrepance midis cilitdo version në të cilin është nxjerrë kjo Rregull, versioni në Anglisht do të mbizotëroj.

Neni 21 : Hyrja në Fuqi

Kjo Rregull duhet të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit.

Neni 22 : Kohëzgjatja

Kjo Rregull do të bëhet e pafuqi dhe e pavlefshme brenda gjashtë (6) muajsh kalendarik nga data e hyrjes në fuqi e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimit të Ujit dhe Mbeturinave i datës 26. Nëntor 2004 që përmendet në Nenin 1 më lartë.



Paulino Brillhante Santos
Drejtor



Afrim Lajci
Zëvendës Drejtor

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

SHTOJCAT

SHTOJCA 1

SHEMBULL I FORMULARIT PËR PËRMBLEDHJEN E BORXHEVE TË VJETRA

KËRKESA PËR PAGESË			
Data		Inspektori i ZRRUM	
Ofruesi i Shërbimeve		Personi Kontaktues	
Konsumatori Ndërkombëtar		Nr. i Kodit të Konsumatorit	

Viti Financiar 2001			
Muaji	E faturuar	E paguar	Balanci
Janar			
Shkurt			
Mars			
Prill			
Maj			
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			
Tetor			
Nëntor			
Dhjetor			
		GJITHSEJ:	

Viti Financiar 2002			
Muaji	E faturuar	E paguar	Balanci
Janar			
Shkurt			
Mars			
Prill			
Maj			
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			
Tetor			
Nëntor			
Dhjetor			
		TOTAL:	

Viti Financiar 2003			
Muaji	E faturuar	E paguar	Bilanci
Janar			
Shkurt			
Mars			
Prill			
Maj			
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			
Tetor			
Nëntor			
Dhjetor			
		TOTAL:	

Viti Financiar 2004			
Muaji	E faturuar	E paguar	Bilanci
Janar			
Shkurt			
Mars			
Prill			
Maj			
Qershor			
Korrik			
Gusht			
Shtator			
Tetor			
Nëntor			
Dhjetor			
		GJITHSEJ:	

SHTOJCA 2
MODELI I KONTRATËS PËR MARRËVESHJEN E PAGESËS

MODELI I KONTRATËS PËR PAGESËN E BORXHEVE TË VJETRA DHE BORXHEVE VIJUESE NDAJ OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT DHE UJËRAVE TË

[Redacted]
(Emri i Ofruesit të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave)

[Redacted]
(Adresa e Ofruesit të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave)

[Redacted]
(Emri i Komunës)

Nr. i Referencës së Ofruesit të Shërbimeve: [Redacted]

Nr. Identifikues i Konsumatorit: [Redacted]

Datë: [Redacted]

Nr i Llogarisë së Konsumatorit: [Redacted]

KONTRATË
PËR PAGESËN E BORXHEVE TË VJETRA

Kjo kontratë është bërë për të bërë të ditur vlerën dhe për të paguar Borxhin e Vjetër dhe Borxhin Vijues për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza në vlerë ("Kontrata") në [Redacted], Kosovë, më date [Redacted], 200_

NDËRMJET

(1) [Redacted] Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave ("Ofruesi i Shërbimeve") dhe

(2) [Redacted] me Nr. të ID [Redacted], dhe adresë kryesore

[Redacted] ("Konsumatori").

Që referohen individualisht si "Palë" dhe kolektivisht si "Palët".

PËRSHKRIMET

Duke marrë parasysh se Konsumatori e ka të njohur:

- (a) ka pranuar shërbimet e ofruara të grumbullimit të mbeturinave nga Ofruesi i Shërbimeve dhe nuk e ka shlyer llogarinë e papaguar, dhe
- (b) Konsumatori njih që ai ose ajo nuk është identifikuar si Konsumatorë i Cënueshëm.

Duke marrë parasysh se Palët pajtohen që Ofruesi i Shërbimeve në mënyrë të kënaqëshme ka demonstruar që ka në shënimet e tij informatat vijues:

- (a) Emrin dhe adresën e saktë të Konsumatorit; dhe/apo
- (b) Historinë e pagesëve të konsumatorit në dosjen e tij, duke përfshirë shënimet e orës atëher kur ka qenë e mundur, dhe

Duke marrë parasysh se Palët pajtohen që kjo Kontratë është lidhë në pajtim me Rregullorën e UNMIK-ut, Rregullin mbi Faljen dhe Shlyrjen e Borxheve të Vjetra për Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave;

Prandaj, në frymën e asaj që u tha më lartë, Palët me këtë pajtohen si vijon:

1. Përkufizimet:

“Borxhi i Vijues” nënkupton të gjitha borxhet e evidentuara nga Faturat e pakontestuar të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve tek Konsumatori me apo pas 1 janar 2003, i cili që nuk është paguar krejtësisht ashtu si është definuar në Rregullin për Falje dhe Shlyerje të Borxhit të Kaluar nga Rregullatori;

“Llogaria e Papaguar” nënkupton llogarinë në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve e cila nuk është rregulluar (paguar) nga Konsumatori në frymën e zakonshme të afarizmit, në lidhje me Borxhin e Vjetër dhe atë Vijues, kur Konsumatori ka marrur Faturat me kohë dhe ka pasë një afat të arsyeshëm për ti paguar.

“Fatura” nënkupton dokumentin e lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve tek Konsumatori i cili shenon shërbimet e kryera, mallrat e dorzuara, Tarifat e Aplikueshme të Shërbimeve, çmimet e tyre apo taksat e aplikueshme, çfarëdo takse apo gjobe zyrtare, dhe shumën totale që ka borxh Konsumatori. Ofruesi i Shërbimeve mundet, sipas vendimit të tij, nëse i kërkohet me ligj apo caktohet nga Rregullatori kohë pas kohe, të përfshijë informata shtesë;

“Borxh i Vjetër” nënkupton të gjitha borxhet e Konsumatorit të evidentuara nga Faturat e pakontestueshme të lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve tek ai Konsumator me apo para 31 dhjetorit 2002, që nuk janë paguar në tërësi siç është përcaktuar në Rregullin e lëshuar nga Rregullatori mbi Faljen dhe Zgjedhjen e Borxheve të Vjetra;

“Konsumator i Cënueshëm” nënkupton:

- Çfarëdo Personi që është i certifikuar nga ndonjë mjek se i është i rrezikohet jeta ose shëndeti pa Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza;
- Secili Konsumatorë i klasifikuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale konform Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/28, Ligji Nr.2003/15 Mbi Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë, si i varfër dhe skamnor, dhe i këshillohet Ofruesit të Shërbimeve që ti mundsohet që faturën e tij ta paguajnë autoritetet e mirëqenies sociale;

Të gjitha shprehjet e tjera dhe frazat e përdorura në këtë kontratë me fjalët e shkruara me shkronja të mëdha do të renditen dhe interpretohen ne përputhje me definicionet e ofruara në Rregullorën e UNMIK-ut dhe në Rregullin mbi Faljen dhe Zgjedhjen e Borxheve të Vjetra,

2. Pranimi dhe Saktësia e Faturës:

- (a) Me këtë Konsumatori pranon se i ka pranuar Faturat, të bashkangjitura në këtë Kontratë, nga Ofruesit të Shërbimit dhe se ato Fatura saktësisht reflektojnë shumën e plotë të Llogarisë së Papaguar që Konsumatori i ka mbetur Ofruesit të Shërbimeve

- (b) Me këtë Konsumatori mëtutje pranon se të gjitha borxhet e përfshira me këtë Kontratë janë shkaktuar gjatë periudhës që ka filluar prej datës [redacted] të muajit [redacted], XXXX dhe ka mbaruar me datën [redacted] të muajit [redacted], XXXX.
- (c) Pagesa që duhet të bëhet nga Konsumatori siç është përcaktuar në këtë Kontratë duhet të përmbajë pagesën e plotë të të gjitha borxheve të Konsumatorit ndaj Ofruesit të Shërbimit.

3. Afatet e Pagesës:

- (a) Pagesa e Plotë sa i përket Konsumatorëve të Regjistruar dhe Faturuar: Konsumatori me këtë pranon obligimin e tij që të paguajë Llogarinë e tij të Papaguar ndaj Ofruesit të Shërbimit për shumën totale prej [redacted] EUR ashtu siç është paraqitur në Faturën e lëshuar nga Ofruesi i Shërbimit në vijim të kësaj Kontrate dhe të bashkangjitur me të;
- (b) Nuk do të Paguhet Kamata: Ofruesi i Shërbimeve nuk do të aplikoj kamatë në shumën që duhet të paguhet për të rregulluar Llogarinë e Papaguar.
- (c) Plani i Pagesës: Ofruesi i Shërbimeve me këtë ofron, dhe Konsumatori pranon që të paguaj shumën e plotë të Faturës sipas një Marrëveshje për Pagesë që përbëhet prej pagesës së kësteve mujore të njejta, në shumë prej [redacted] EUR (shkruani shumën me shkronja) për [redacted] muaj, duke filluar me me pagesën e parë që duhet të bëhet më date [redacted].

4. Të Tjera

- (a) Ligji Qeverisës dhe Kontestet: Kjo Kontratë dhe të drejtat dhe obligimet e Palëve që dalin nga kjo do të qeveriset, interpretohet dhe spjegohet duke u bazuar në ligjet e Kosovës dhe çfarëdo kundërthënje tash e tutje do të jetë qështje për zgjedhje në gjyqet e Kosovës.
- (b) Marrëveshja e Plotë: Kjo Kontratë, së bashku me Faturën e bashkangjitur, paraqet marrëveshjen e tërësishme në mes të Palëve në lidhje me pagesën e borxhit, dhe mbizotron mbi të gjitha marrëveshjet paraprake me gojë ose me shkrimi në mes të Palëve që kanë të bëjnë me këtë Kontratë.
- (c) Bartja: Palët pajtohen që: Ofruesi i Shërbimit nuk do të ketë të drejtë me këtë Kontratë që ti bartë ndonjë apo të gjitha të drejtat dhe intereset e veta çfarëdo personi tjetër pa pëlqimin e konsumatorit; dhe se Konsumatori me këtë Kontratë nuk do të jetë në gjendje që ti barti të drejtat apo obligimet ndonje personi të tretë pa marrur pëlqimin me shkrim nga Ofruesi i Shërbimit.
- (d) Palët: kjo kontratë është lëshuar në dy (2) kopje origjinale, ku secila nga palët do të mbajë nga një kopje.

SI DËSHMI se kjo Kontratë është ekzekutuar në ditën e parë të shkruar më lartë nga:

Për dhe në emër të: [redacted]
(Emri i Ofruesit të Shërbimeve)

Përfaqësuar nga: [redacted]
(Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar)

Nënshkrimi: [redacted] Datë: [redacted]

Për dhe në emër të: [redacted]
(Emri i Konsumatorit)

Përfaqësuar nga: [redacted]
(Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar)

Nënshkrimi: 

Datë: 